



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina



## EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 11.4.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Besa Halimi - Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mehdiu, Sadri Ramabaja, Afërdita Velu dhe Engin Beyoglu.

**Mungoi** Liridon Restelica.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE - së, të INPO-së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit. Ai i njoftoi të pranishmit, se në seancën e radhës do të jetë informata për shpenzimet dhe të hyrat e buxhetit për tremujorin e parë. Njëherësh do të jetë edhe informata e Komisionit të aksionarëve për ndërmarrjen "Trafiku Urban", për të cilën jemi pajtuar.

**U konstatua se njëzëri u miratua ky**

### REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt;
2. Propozimrregullorja për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës;
3. Propozimrregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit në Komunën e Prishtinës;
4. Propozimstatuti i Arkivit Komunal të Prishtinës;
5. Propozimstatuti i bibliotekës komunale "Hivzi Sylejmani" Prishtinë;
6. Propozimstatuti i teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";
7. Propozimvendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës;

## 8. Propozimvendimi për dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm NPK

“Hortikultura” SHA në Prishtinë;

## 9. Pyetje dhe përgjigje;

## 10. Të ndryshme

### Pika e parë

**Bekim Gashi** bëri vërejtje në ekstrakt, duke shtuar se në ekstrakt shënon se unë kam munguar në seancën e fundit, por unë kam qenë i pranishëm në mbledhje.

**Sadri Ramabaja** bëri vërejtje në transkriptin e mbledhjes, duke shtuar se në transkript nuk janë shënuar kush ka votuar kundër, kush pro etj. etj. Do të ishte mirë që të shënohen se edhe ai është dokument.

**Besa Halimi-Zagragja** bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se unë kam thënë që duhet të shënohen edhe sqarimet e drejtorëve, sepse shpeshherë ato përmbajnë diçka që ne mund të mos jemi dakord që të votohen.

**Me vërejtjet e dhëna, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit.**

### Pika e dytë

**Lidhur me Propozimrregulloren për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës, informoi Agim Salihu**, shef i Zyrës ligjore, duke cekur se në bazë të dispozitave të nenit 10 të Ligjit nr. 03-145, për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, dhe të nenit 17 të Udhëzimit administrativ nr. 9/2010, për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë, dhe pas pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Zyrës ligjore, ka ardhur si propozim kjo rregullore.

**Bekim Gashi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimrregullore, dhe konsiderojmë se neni 6, paragrafi a, duhet të riformulohet më mirë. Propozojmë që kjo dispozitë të riformulohet si vijon: *“Të bashkëpunojë me këshillat rinor në nivel lokal, dhe këshillin rinor në nivel qendror, lidhur me çështjet që prekin interesat e rinisë me institucionet e tjera publike, private, vendore dhe ndërkombëtare.”* GP i LDK-së e përkrah miratimin e propozimrregullores.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se e përkrahim këtë rregullore, por kishim kërkuar nga drejtoresha që mos të jetë vetëm miratim i një rregulloreje, por të jetë edhe një pasqyrë e rinisë, që do të tregonte çka ka punuar dhe çka është duke punuar tash rinia e Prishtinës. Këtë propozimrregullore e përkrahim për miratim.

**Skënder Reçica**, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne në parim e përkrahim Rregulloren për funksionimin e Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës. Në parim rregullorja duket krejt në rregull, por sigurisht që ne jemi kureshtar të dimë se çka ka bërë ky këshill gjatë vitit e kaluar. Do të ishte mirë që kjo rregullore të përcillej me një raport të shkurtër nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të paktën të shohim ndonjë aktivitet që ky këshill e ka ndërmarrë gjatë vitit

të kaluar. Po ta kishim pasur ndonjë raport përpara , sigurisht se do të kishim dhënë ndonjë vlerësim.

Si GP këtë propozimrregullore e përkrahim për miratim.

**Kryesuesi** tha se Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e ka prezantuar Planin vjetor dhe se Planin e Forumit Rinor e kemi miratuar vitin e kaluar, pra kjo është rregullore që po miratohet për herë të parë.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar këtë rregullore dhe pajtohemi me atë vërejtje që u dha edhe nga GP i LDK-së, ngase është e nevojshme që të shkoqitet ajo pjesë në këtë rregullore, sepse mendojmë që megjithatë ajo vetëm do ta pasuronte dhe do ta plotësonte rregulloren. Ne përgëzojmë për këtë, sepse kjo fushë, ky lëmë vërtet ka mbetur i papërpunuar deri tash, gjegjësisht i paorganizuar dhe, në anën tjetër, është një kapital i çmuar i vendit tonë, prandaj jemi për ta votuar këtë rregullore.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, tha se duke e ditur se rinia është pjesa vitale dhe aktive e një shteti, i përgëzoj iniciatorët e kësaj rregulloreje. Rregullorja i detajon të gjitha procedurat që nga iniciimi për formimin e KVRL-së, mbajtjen e Kuvendit për themelimin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, zgjedhjen e Bordit ekzekutiv, hartimin e Statutit dhe Rregullores së punës, kërkesën për regjistrim, sipas ligjit në fuqi për organizatat jo fitimprurëse dhe, në fund, kërkesën me shkrim për njohje në drejtorinë përkatëse për punën me rininë. Është detajuar edhe përfaqësimi, detyrat, përgjegjësitë, funksionimi, burimet financiare etj. Si GP e përkrahim këtë Rregullore.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë tha se edhe ne do ta përkrahim, me këto plotësimet që u dhanë, por në qoftë se ka edhe ndonjë plotësim tjetër, ne do të qëndrojmë pas atyre, në mënyrë që kjo rregullore të jetë në funksion të zhvillimit të rinisë në mënyrë sa më të mirë, sepse duket që me rininë nuk është punuar sa duhet, i kemi lënë pak anash. Duhet të përpiqemi më shumë që t'i kemi në funksion të ndërtimit sa më të shëndoshë, sa më të mirë për të ardhmen e Prishtinës dhe të gjithë vendit.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se kjo rregullore relativisht mirë përcakton obligimet dhe detyrat e Komunës në raport me pjesën më të madhe të popullsisë dhe të kryeqendrës sonë, sepse kemi të bëjmë me 70% të popullsisë. Neni 2 i përcakton relativisht qartë përkufizimet se çfarë nënkuptojmë etj., por neni 4, pikat **a**, **b** dhe **c**, kupton se përfaqësimi i organizatave të grupeve rinore, të bëhet sipas nenit 11 të Udhëzimit administrativ. Do të ishte mirë që kësaj rregulloreje t'i ishte bashkëngjitur ai Udhëzim administrativ, që ne ta kemi parasysh se si e rregullon këtë përbërje. Megjithatë, si dokument bazë juridik që i duhet rinisë, këtë rregullore ne e mbështesim për miratim.

**Besa Halimi - Zagragja** tha se vërejtjen që e bëri anëtari i GP të LDK-së për nenin 6, mendoj që mund të jetë jo krejt e qëlluar, pasi që, me sa po e kuptoj unë, kjo pikë po ndërlihet pak edhe me nenin 10, pika **d**, është fjala jo për veprimtarinë që e ushtrojnë ato, por për nivelet në të cilat duhet të shtrihet veprimtaria e tyre, pra jo për çështjet me të cilat merren.

**Kryesuesi** tha se propozimi i dhënë nga anëtari i GP të LDK-së, ka qenë vetëm një interpretim ashtu si është në udhëzim. Lidhur me këtë çështje, kërkoi nga

Zyra ligjore që të bëhet ky përmirësim, po ashtu edhe ato që i potencoi z. Ramabaja.

**Njëzëri u miratua Rregullorja për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës.**

## Pika e tretë

**Lidhur me Propozimrregulloren për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit në Komunën e Prishtinës, Agim Salihu** tha se grupi punues iu ka qasur harmonizimit të obligimeve që i ka nga ligjet dhe udhëzimet administrative. Kjo rregullore është bazuar në obligimet që i ka pasur Komuna karshi Ligjit nr. 03-L-145, për fuqizimin dhe pjesëmarrjet e rinisë, dhe të dispozitave të Udhëzimit administrativ nr. 10/ 2010. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit, i marrëdhënieve që krijohen në mes të vullnetarëve dhe subjektit juridik, organizatorët e vullnetarizmit për nxitjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në Komunën e Prishtinës.

**Bekim Gashi**, në emër të GP të LDK-së, tha se këtë rregullore e kemi shqyrtuar dhe konsiderojmë se Propozimrregullorja i plotëson të gjitha kriteret e bazuara në Ligjin për fuqizimin e rinisë, dhe në pajtim me aktet e tjera normative. GP i LDK-së vlerëson lart punën e drejtoreshës së kësaj drejtorie, duke e veçuar Komunën e Prishtinës si komuna e parë që po ndërmer hapat e parë për miratimin e rregulloreve që dalin si obligim ligjor për fuqizimin e rinisë. Si GP i LDK-së, e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim.

**Milazim Vitia**, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu këtë rregullore për miratim.

**Besa Halimi-Zagragja**, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu miratimin e kësaj rregulloreje dhe shprehu kënaqësinë që, më në fund, vullnetarizmi nuk po mbetet vetëm veprimtari e OJQ-ve, dhe e personave fizikë me iniciativa të herëpashershme, por po bëhet edhe institucionale dhe me rregullore të veçantë.

**Astrit Hasani**, në emër të GP të AAK-së, tha se e përkrahim dhe e përhëndesim punën që është bërë për këtë rregullore, por kërkojmë që, në njërin nga nenet, të parashihet edhe shkëmbimi i vullnetarëve nga komuna e Prishtinës me komunat tjera në Kosovë, rajon, Evropë e më gjerë, në mënyrë që të shkëmbehen eksperiencat dhe ato eksperiencia të barten në komunën tonë.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, e përkrahu këtë rregullore, kuptohet për sportin, rekreacionin, punën kreative, por unë nuk do ta përkrah punën fizike sikur dikur në vitet e 70-ta, sepse neve na duhet t'i rrisim këta njerëz me një trup pak më të shëndoshë, që ajo bëhet vetëm me rekreacion, me punë rekreative, punë të lehta e jo me punë të rënda, sepse tash ka teknikë dhe teknologji që i lehtësojnë punët fizike.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne do të qëndrojmë pas përkrahjes së kësaj rregulloreje, me një sugjerim te neni 8, ku është një formulim, i cili, në një farë mënyre bie ndesh me parimet natyrore. Është bërë një lloj shablloni ky orientimi seksual. Orientimin seksual unë besoj që nuk mund ta caktojnë, as nuk mund ta kërkojnë medoemos as institucionet, as individët. Më mirë do të ishte që ky formulim mos të figurojë aty.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se aktivitetet e punës vullnetare janë paraparë në nenin 17, pra kemi të bëjmë me aplikimin e atyre projekteve që parashihen në planin e punës. Nëse organizohet ndonjë aktivitet jashtë planit, do të evidencohet si keqpërdorim i situatave të çastit, të punës etj. Prandaj, përgëzoj drejtoreshën që e ka iniciuar, por edhe autorët e Rregullores për këtë precizim. Kam një dilemë për pikën 1, neni 16, sepse në këtë mënyrë realisht ne po përpiqemi të keqpërdorim buxhetin ose të kushtëzojmë me buxhetin e Komunës. Unë kisha propozuar që kjo pikë të hiqet. Kjo rregullore në esencë flet për shtetin kreativ, respektivisht për

shtetin proaktiv, për një tip të qytetarit të ri, i cili angazhohet për çdo ditë në shërbim të së mirës publike. Neni 4 e precizon jashtëzakonisht mirë këtë filozofi të mendimit politik, prandaj do të ishte mirë që kjo t'i lihet vullnetit të mirëfilltë politik të rinisë për të mirën publike, e jo të nxitet me bursë ose me shpërblime të kësaj natyre.

Ne si Vetëvendosje, plotësisht e mbështesim këtë rregullore, me këto dy vërejtje.

## **Njëzëri u miratua Rregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit në komunën e Prishtinës.**

### **Pika e katërt**

**Për Propozimstatutin e Arkivit Komunal të Prishtinës, Agim Salihu** tha se ky propozim është mbështetur në dispozitat e nenit 18 dhe respektimit të afatit sipas Ligjit nr. 04 -L-088, për arkivat shtetërore. Grupi punues para se ta bënte finalizimin e këtij teksti, e ka bërë shqyrtimin e tij edhe me stafin udhëheqës dhe stafin e të punësuarve të Arkivit Komunal.

**Flamur Shala**, në emër të GP të LDK-së, tha se ky propozimdokument është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për funksionimin e Arkivit Komunal të Prishtinës. Është i rëndësishëm, sepse si i tillë ka dalë i harmonizuar me Ligjin në fuqi. Dihet, ligji ka ndryshuar, andaj edhe Statuti i Arkivit do të duhej të ndryshonte. Ne këtë e shohim si të ndryshuar edhe në aspektin e statusit që ka Arkivi dhe veprimtarisë së Arkivit, organizimit, përcaktimit të organeve të Arkivit, financimit etj., gjithnjë në mbështetje dhe në bazë të Ligjit. Bazuar në këtë, GP i LDK-së e voton për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se pasi që janë bërë ndryshime të ligjit, kisha kërkuar nga personi i Zyrës ligjore të na tregojë ndryshimet që janë bërë në këto tri statute, cili statut ka ndryshime prej të kaluarit dhe sa ka ndryshime.

Këtë propozimstatut e votojmë për miratim, me kërkesën që të na tregohet për ndryshime.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë edhe disa vërejtje në mbledhjen e KPF-së, por me një sugjerim që ndoshta te neni 29, që flet rreth sekretit zyrtar në Arkiv, do të doja të dijë se a është konsultuar mirë Zyra ligjore me ligjin, faktikisht qasja në dokumente zyrtare, kështu që kjo të mos mbetet diçka në amulli. Duke pasur parasysh këto, e përkrahim për miratim këtë propozimstatut.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, tha se duke pasur parasysh se vërejtjet dhe sugjerimet tona të dhëna në KPF, e që në tërësi janë inkorporuar në tekstin përfundimtar, si GP e përkrahim për miratim këtë propozimstatut.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, shprehu mendimin se ligji duhet të parasheh që arkivat të obligohen për të bashkëpunuar mes vete, d.m.th. arkivat komunale mes vete dhe me arkivin qendror, pra të bashkëpunojnë me komunat tjera, si p.sh. me komunën e Lipjanit, të Ferizajt, të Pejës etj. Mendoj që është dashur që të futet në statut, si normë juridike e miratuar, që arkivat të kenë një bashkëpunim të vaçantë zyrtar të obliguar në mes veti për shkëmbimin e dokumenteve që i ruajnë ato. Si GP këtë propozimstatut e përkrahim për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu miratimin e Statutit të Arkivit Komunal të Prishtinës, duke i shtuar edhe dy sugjerime.

Në nenin 20, në rreshtin e dytë, propozoi që pas fjalës *“interesat”*, t’i shtohet *“e përgjithshme të Arkivit”*. Në nenin 22, pika 2, që ka të bëjë me aktet që duhet të nxirren në afat prej tre muajsh, kjo është një çështje që ne shpeshherë e kemi diskutuar dhe na brengos që nuk e shohim në disa akte kështu. Është mirë kufizimi, sepse kjo shkon në të mirë të shtimit të kualitetit të organizimit të jetës shoqërore.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se vitin e kaluar kemi propozuar që Arkivi të quhet Arkivi i Qytetit të Prishtinës, ashtu siç ekzistojnë në kryeqendrat botërore evropiane, që besoj se do t’i shkonte shumë më mirë. Vërejtje bëri në nenin 10, që ka të bëjë me emërimin e drejtorit, dhe propozoi që në fund të pasusit të këtij neni të shtohet: *“Personi që ka përgatitje profesionale në fushën e arkivit, si arkivist, historian, arkeolog etj.”*, sepse ky përgjithësim lë mundësi për keqpërdorime. Në nenin 20, pjesa e fundit e fjalisë, ku thuhet: *“ ... me vendim të veçantë të Komunes”*, të hiqet dhe në vend të saj propozoi të jetë: *“ ... të cilat janë paraparë me ligj”*. Me këto vërejtje, këtë propozimstatut e mbështesim për miratim.

**Naim Makolli** bëri vërejtje në nenin 21, që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të punonjësve për Statutin e arkivit dhe për Statutin e bibliotekës *“Hivzi Sylejmani”*, pasi që për këtë çështje statutet ngjasojnë njëri me tjetrin. A kanë të drejtë ata të zhvillojnë aktivitet sindikal brenda kolektivit të tyre, sepse këtu thuhet se për të drejtat e tyre mund t’i drejtohen drejtorit etj., ndërsa te Statuti për teatrin e Prishtinës *“Dodona”*, më duket se është i formuluar pak më mirë, ku thuhet se realizimi i të drejtave të punonjësve bëhet duke u bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi dhe rregullojnë mbrojtjen dhe të drejtat e tyre. Unë kisha propozuar që ky nen i Statutit të teatrit të qytetit *“Dodona”*, të futet edhe tek Statuti i Arkivit Komunal të Prishtinës, njëkohësisht edhe te Statuti i bibliotekës komunale *“Hivzi Sylejmani”* në Prishtinë, sepse sipas Ligjit të punës, çdo kolektiv, çdo njësi punuese ka të drejtë në organizim sindikal, ndërsa me këtë më duket se është një anomali e vogël në atë drejtim.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, sqarime shtesë dha **Agim Salihu**.

**Njëzëri u miratua Statuti i Arkivit Komunal të Prishtinës.**

**Pika e pestë**

**Lidhur me Propozimstatutin e bibliotekës komunale “Hivzi Sylejmani” Prishtinë, në pika të shkurtra njoftoi Agim Salihu**, duke thënë se në pajtim me dispozitat e nenit 27 të Ligjit për biblioteka, parashihet që institucionet të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre me ligjet që janë në fuqi.

Në rastin konkret, Ligji nr. 04-L-097, për bibliotekat, e ka rregulluar këtë çështje. Me këtë statut është paraparë që të rregullohet statusi i bibliotekës komunale *“Hivzi Sylejmani”* në Prishtinë, veprimtaria e bibliotekës, struktura, organizimi dhe financimi i bibliotekës, planifikimi dhe transparenca.

**Tefik Mehmeti**, në emër të GP të LDK-së, e përshëndeti grupin punues për punën që ka bërë. Është e vërtetë që në KPF i kemi dhënë disa vërejtje, disa prej tyre sigurisht që janë pranuar, dhe ne si GP i LDK-së pajtohemi me këtë statut dhe jemi për miratimin e tij.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu propozimstatutin për miratim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu propozimstatutin për miratim.

**Astrit Hasani**, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu propozimstatutin për miratim.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, e përkrahu propozimstatutin për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të PD-së, e përkrahu propozimstatutin për miratim.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se Statuti i bibliotekës komunale "Hivzi Sylejmani" ka pothuajse të njëjtin formulim në nenin 9, sikurse ai te Arkivi. Për të qenë më i formuluar neni 9, propozoj që t'i shtohet : " *Duhet të ketë përgatitje superiore në fushën përkatëse të bibliotekarisë, të letërsisë etj.* ". Përkrahu miratimin e propozimstatutit, me vërejtjen e dhënë.

**Njëzëri u miratua Statuti i bibliotekës komunale "Hivzi Sylejmani" Prishtinë.**

## **Pika e gjashtë**

**Për Propozimstatutin e teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona", Agim Salihu** iu tha të pranishmit se ky statut e ka bazën në nenin 25, paragrafi 2 të Ligjit për teatrot. Me këtë propozim është bërë rregullimi i fushës së teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona", themelimi, organizimi, funksionimi, drejtimi, udhëheqja, financimi, planifikimi, transparenca dhe çështje të tjera të rëndësishme për rregullimin e fushave të teatrove.

**Ajnishahe Azemi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar propozimin e statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona" dhe konstatojmë se është në harmoni me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për teatrot, i cili rregullon statutin e teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona", themelimin, organizimin, drejtimin, udhëheqjen, financimin, planifikimin, transparençën dhe çështje të tjera të rëndësishme për teatrin.

Si GP e përkrahim për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, kërkoi nga kryesuesi të japë sqarim për vërejtjet që janë dhënë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Ka pasur vërejtje edhe për emrin se pse quhet Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona", pra të dihet arsyeja pse është titulli i tillë.

**Kryesuesi** tha se çështja e emërimit është e definuar sipas ligjit, pra emërtimi është drejt i shkruar.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se me që emërtimi është i definuar sipas ligjit, edhe ne pajtohemi dhe e përkrahim këtë propozimstatut për miratim.

**Astrit Hasani**, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu propozimstatutin, mirëpo për shkak që financohet nga Komuna e Prishtinës dhe që ai të jetë shumë më aktiv, propozoi që shkollat e Prishtinës, secila klasë, çdo javë nga një klasë të shkojë të shikoj falas nga një shfaqje.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, shprehu mendimin se meqë ky statut është tekst i spastruar i Statutit të miratuar në vitin 2011 dhe ndryshimet e propozuara për

teatrot sipas ligjit të ri janë inkorporuar, ne i përkrahim këto ndryshime dhe jemi për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahim këtë propozimstatut, duke iu qasur si një institucion pak më specifik se ata dy të mëparshmit. Si institucion që ka të bëjë me një sferë të artit, mendojmë se është mirë që te neni 9 dhe te neni 13, të jetë *“tri vjet përvojë pune”*, por në çfarë institucioni? Do të ishte mirë të jetë: *“përvojë pune në institucione të ngjashme”*, sepse është teatër dhe ka disa specifika nga institucionet tjera. Edhe përkundër asaj se kjo është e paraparë me ligj, por ligji nganjëherë nuk i ka disa gjëra kështu të imtësuar.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se emërtimi i këtij institucioni është ndoshta emri më i qëlluar i një institucioni kulturor që ka Kosova dhe, për fat të mirë, në këtë emërtim kanë ndikuar profesionistët dhe jo dikush tjetër, prandaj edhe i ka qëndruar kohës.

Edhe Teatri i qytetit të Prishtinës *“Dodona”*, do duhej të ishte një institucion me të cilën do të krenohej Prishtina. Kishim po të njëjtat vërejtje te neni 9 dhe te neni 13. Në nenin 9, propozoj që kjo të trajtohet ashtu siç propozuam edhe për nenet e ngjashme te statutet tjera, ndërkaq në nenin 13, që ka të bëjë me kushtet e përgjithshme për emërim, ndoshta do të ishte mirë që ky nen të jetë më i formuluar dhe kërkojmë që të precizohet dhe aty, në vazhdim të pasusit të thuhet: *“të ketë përgatitje superiore të fushës përkatëse, si regjisor, dramaturg, shkrimtar etj.”*

**Njëzëri u miratua Statuti i Teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”.**

#### **Pika e shtatë**

**Lidhur me Propozimvendimin për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës, Agim Salihu** tha se ky propozimvendim ka të bëjë me marrjen e vendimit nga ky Kuvend për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve që janë në pronësi të Komunës, të cilat kanë qenë të parkuara në parkun e automjeteve të Komunës dhe kanë të bëjnë me veturat të cilat janë marrë nga *“Merimanga”* apo raste të tjera.

**Aziz Pacolli** tha se pasi që është një vendim për shpallje të ankandit publik për shitjen e automjeteve, kisha kërkuar që pas përfundimit të ankandit, në të njëjtën mënyrë si po kërkohet të merret vendim për ankand, të na silltet një lloj informate lidhur me rrjedhën e procedurave të shitjes.

#### **Pika e tetë**

**Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm NPK “Hortikultura” SHA në Prishtinë, Agim Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, tha se është propozuar që kësaj ndërmarrjeje t’i jepet në shfrytëzim një lokacion për kultivimin e luleve dhe fidanëve.



**Vjollca Rizani** tha se GP i LDK-së e ka analizuar këtë propozimvendim, i cili ka të bëjë me dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm dhe njëzëri e përkrahim dhe do ta votojmë.

**Shemsi Veseli** ceku se meqë është NPK 100%, do të ishte mirë që kur të bëhet marrëveshja, të kërkohet që shërbimet mos të na i bëjnë me pagesë, sepse ajo po e merr token e Komunës për shfrytëzim, po e ka gjenerimin e mjeteve materiale dhe shërbimet po na i paguan. Kërkoj që kjo të merret parasys.

**Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm NPK "Hortikultura" SHA në Prishtinë.**

**Pika e nëntë dhe e dhjetë**

**Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

**Shefki Ghashi** tha se fletushka "Prishtina 2012", e cila na u dha sot, mendoj se i mungojnë disa saktësi, që mendoj se duhet t'i ketë. Në vitin 2012 ka pasur Kuvend Komuna e Prishtinës, ka funksionuar ai Kuvend, kanë pas emra dhe mbiemra ata njerëz, kanë pas subjektin politik, ka pas një ekzekutiv, pra kanë pasur emër dhe mbiemër që kanë pasur përcaktimin politik ose profesional dhe është dashur të gjejnë vend në këtë broshurë. Zyra për marrëdhënie me publikun nuk e ka bërë këtë në mënyrë vullnetare, me siguri është paguar, kështu që është dashur të jetë pak më e kompletuar.

**Abdullah Hoti** tha se qëllimi i kësaj fletushke ka qenë prezantimi i aktiviteteve të Komunës, investimet që janë bërë nëpër fusha të ndryshme, si për informim për qytetarë, nuk ka për qëllim promovimin e asnjë personi në Komunë, as të Kuvendit, as të ekzekutivit, e as të askujt. Për korrektësi, në fund e kemi prezantuar një listë të mbledhjeve të Kuvendit komunal, të Komitetit për Politikë dhe Financa, të Këshillit të Drejtorëve dhe të këshillave të tjerë në pjesën e fundit të raportit. Qëllimi ka qenë vetëm informimi i qytetarëve për projektet që janë realizuar gjatë vitit 2012.

**Sadri Ramabaja** shprehu mendimin se nuk i bënë nder Komunës që e ka publikuar tani këtë bllok fushativ me fotografi, sepse të gjitha fotografitë e theksuara këtu janë përqendruar ekskluzivisht te kryetari, nënkryetari dhe 2-3 vetë të tjerë.

Te puna e kryer, qysh në fjalën e parë në titullin e broshurës, kemi një s'përputhje të plotë të realitetit me këtë çka është theksuar këtu. Thuhet se është investuar në çdo cep të Prishtinës, por në lagjen time nuk ka ende ujësjellës, nuk është investuar që dhjetë vjet atje etj., çka do të thotë se praktikisht ky bllok është shprehja më e qartë e keqpërdorimit të buxhetit.

Ne si grup parlamentar, në mbledhjen e kaluar parashtruam dy pyetje dhe nuk kemi marr përgjigje as unë, as kryetari i Bashkësisë Lokale në lagjen "Arbëria".

Rendi e do që përgjigjet t'i marrim zyrtarisht këtu pastaj të shkojmë tutje përmes mediave.

Bashkësia Lokale në lagjen "Arbëria" është krejtësisht jashtë funksionimit. Ne e kemi sjellë një pyetje që praktikisht tregon modelin e veprimit në bashkësitë lokale gjithandej në Prishtinë, asnjë forcë politike nuk ka mundësi t'i shfrytëzojë këto bashkësi lokale, madje-madje, çka është edhe më keq, as vet bashkësitë lokale, p.sh.

në lagjen "Arbëria" kryetari i BL-së me ekipin e tij nuk kanë mundësi ta shfrytëzoj, sepse është dhënë me qira, madje veprimet nga shoqata janë arrogante edhe me përfaqësuesit e popullit. Kërkojmë dhe insistojmë që përgjigja të na jepet me shkrim për rastin e parë dhe të dytë ( për pyetjet e parashtruar nga Afërdita Veliu).

Lidhur me vërejtjet e dhëna nga z. Ramabaja, **Avdullah Hoti** tha se të gjitha këto që po i shihni në këtë broshurë, janë të nxjerra nga raporti, të cilin ju vet e keni miratuar, prandaj është jo korrekte me dhënë vërejtje për tekstin ose për gjëra tjera të cilat lidhen me këtë. Për ata që kanë qenë në Kuvend komunal, e dinë se kjo nuk është fushatë, por është raport, publikim që është nxjerrë prej se ekziston Kuvendi komunal.

**Feti Mehdiu** bëri një sugjerim për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, që ka të bëjë me shqetësimin e qytetarëve të Koliqit. Lidhur me këtë tha se i bashkohemi atij shqetësimi të 135 nënshkruesve që kanë kërkuar rregullimin e transportit të udhëtarëve. U paraqit arsyetimi se nuk është linjë profitabile. Ne mendojmë se këtu do të intervenojë Komuna me buxhetin e vet, për shkak se këtu duhet të arrihen dy qëllime, njëri humanitar, kurse tjetri mund të jetë strategjik. Humanitar është për shkak se janë banorë të komunës së Prishtinës dhe e kemi detyrë të iu sigurojmë së paku tri herë në ditë një mjet transporti, në mënyrë që ata banorë të shkojnë në qytet dhe të kthehen në shtëpi. Qëllimi strategjik mund të jetë se vetëm atje mund të kultivohet një veprimtari që nuk bënë në Prishtinë, p.sh. bletaria, pemëtaria, blegtoria etj., që janë me leverdi jo profitabile momentale, por për të ardhme.

Për shqetësimet e shfaqura lidhur me gjetjen e mundësisë për lëshimin e një vije të transportit të udhëtarëve për në fshatin Koliq, **Kryesuesi** tha se duhet të shikojmë mundësinë për ndonjë operator të vogël, por nëse hyjmë në kuptimin e asaj që ne duhet të bëjmë subvencionime, atëherë kjo duhet të shqyrtohet, sepse nuk mund ta dallojmë vetëm dikë, atëherë do të kemi shpenzime shumë.

**Shefki Gashi** tha se ai numër i banorëve nuk përputhet me nënshkrimet e dhëna, por a duhet Komuna që t'iu krijojë mundësi edhe atyre 2-3 shtëpive që kanë mbetur me një vijë të autobusit, unë mendoj se po. Mendoj se me një minibus mund të mbahet ajo linjë, por duhet llogaritur se kemi edhe vija të tjera që kanë nevojë për shërbime të tilla, siç është fshati Shahkocë, i cili ka mbetur si një oazë në mes të gjitha komunave dhe nuk ka fare lidhje transporti.

**Agim Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se Komuna është në përfundim të projektit për shpalljen e tenderit për të gjitha linjat për komunën e Prishtinës, dhe pjesë e saj është edhe zona rurale, përkatësisht linjat që nuk kanë rentabilitet. Në bazë të projektit parashihet subvencionimi nga Komuna.

**Naim Makolli** kërkoi të dijë se, a është vizituar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale familja që është vendosur në ish-kazermën e Llukarit dhe a është bërë diçka për atë familje të Prishtinës.

Edhe te fletushka kemi një defekt, sepse nuk përputhet fotografia me raportin që është dhënë, se thuhet asfaltimi i rrugës në Marevc, në vitin 2012, dhe në fakt nuk është shtruar asnjë metër asfalt në Marevc.

**Valbon Krasniqi**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, tha se familjen e strehuar në ish-kazermën e Llukarit e ka vizituar shefi i Sektorit social, bashkë me punëtorët e Qendrës për Punë Sociale, dhe e kanë bërë një anamnezë sociale, të cilën ma kanë dërguar para dy ditësh, por jemi ende në kërkim të dokumenteve, që edhe punëtorët socialë janë duke analizuar mënyrën si ka ardhur, ku ka banuar më parë, cilat janë mundësitë dhe çka mund të ndërmerret për këtë rast.

**Milazim Vitija** tha se në Komitetin për Politikë dhe Financa i bëmë disa pyetje, sepse kemi dashur vazhdimisht ta kursejmë kohën në Kuvend, por meqë qenka prezent drejtori i Infrastrukturës, desha t'ia bëjë disa pyetje.

Siç dihet, vitin e kaluar me shefat e grupeve parlamentare, të gjitha prioritetet e rrugëve që kanë qenë nga bashkësitë lokale, kanë kaluar nëpërmes shefave të grupeve parlamentare dhe në mesin e tyre kanë qenë edhe nja katër rrugë apo pesë, që kanë pasur prioritet me hy në vitin 2013 në Marevc.

Kanë qenë disa të asfaltuara dhe disa të trasohen me zhavorr. Mirëpo në bazë të të dhënave që i kemi ne dhe prioriteteve që i kemi parë, nuk ka hy në këtë vit asnjë rrugë. Ne kemi biseduar edhe me kryetarin, mirëpo është mirë që të bisedojmë edhe me drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës lokale, dhe të marrim përgjigje pikërisht për këtë pyetje.

**Ridvan Shahini**, drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se për këtë vit në program për realizim është vetëm rruga Viti – Bullaj, e cila do të shtrohet me asfalt.

**Shemsi Veseli** tha se sa i përket fletushkës “Prishtina 2012”, do të duhej që, së paku në 2-3 faqet e para, të përfshihet komplet stafi politik, ekzekutiv dhe është dashur të ceket se vendimet i ka marrë Kuvendi komunal brenda vitit 2012, sa rregullore janë harmonizuar, dhe unë mendoj se kjo i kishte bërë nder më të madh institucionit të Komunës.

Çështja tjetër është që për mbledhjen e radhës të jetë një informatë për gjendjen ekonomike – financiare për tremujorin e kaluar.

Shqetësim tjetër që duhet ngritur është edhe rreziku nga qenët endacakë, sidomos te Parku Memorial, te varri i ish-Presidentit Rugova dhe në QKUK, ku ka shumë të tillë, prandaj është mirë që të merren masa, ku intervenimet që po bëhen për kastrimin e qenve të jenë më profesionale, për arsye se ka ankesa prej qytetarëve dhe ka vërejtje se ka edhe qenë të gjakosur, të cilët munden t'iu shkaktojnë ndonjë lloj infeksioni. Do të duhej të merreshin masa më rigorozë dhe të jenë në mbikëqyrje më të sforcuar.

**Kryesuesi** tha se informata për gjendjen financiare do të jetë në seancën e radhës, e cila do të mbahet gjatë këtij muaji. Po ashtu, informatën të cilën e kemi kërkuar nga “Trafiku Urban”, ne u pajtuam edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, të japim pak kohë, se ka informacione, ka letra tjera, takime dhe sigurisht që Komisioni i aksionarëve do ta japë informatën.

*Mbledhja mbaroi në orën 12:30.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**